



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-34717/22 datë: 20.12.2022



Npi – 01/430 datë: 23.12.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 23.12.2022, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S Ë -IX- T Ë K O M I T E T I T P Ë R K O M U N I T E T E

E mbajtur më: 23.12.2022 (e premtë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë , Zëvendës Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Arton Demiri, znj.Shkurte Mustafa dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: z.Ibrahim Demiri dhe znj.Valmira Hoxha - praktikante.

Mbledhjen e hapi zv.Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se me 24.11.2022,
2. Draft – plani i punës, të Komitetit për Komunitete për vitin 2023,
3. Diskutim për Draft – Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023,
4. **Diskutim për Propozimin e Drejtorisë për Shërbime Publike për ngritjen e çmimeve të shërbimeve të KRM “Pastërtia” SH.A Ferizaj, Njësia në Shtime. (u largua nga rendi i ditës)**
5. Të ndryshme.

zv.Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti; Pasi që po mungon Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, po e udhëhoqi mbledhjen unë. Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, sa i përket pikave të rendit të ditës, nga Kuvendi Komunal, dje që është mbajtur e shohim se nuk përputhen me pikat e Kuvendit, kërkojmë me u shty pikat. Unë propozoj që pika 3 (Diskutim për Draft – Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023) dhe pika 4 (Diskutim për Propozimin e Drejtorisë për Shërbime Publike për ngritjen e çmimeve të shërbimeve të KRM “Pastërtia” SH.A Ferizaj, Njësia në Shtime) të hiqen nga rendi i ditës. Po tërhiqem nga propozimi për pikën 3 dhe le të mbetet, vetëm pika 4 që të hiqet, me arsyetimin që kemi lidhmëni me Kuvend.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi propozimin e Besnik Seferi që pika 4 (Diskutim për Propozimin e Drejtorisë për Shërbime Publike për ngritjen e çmimeve të shërbimeve të KRM “Pastërtia” SH.A Ferizaj, Njësia në Shtime) të hiqet nga rendi i ditës.**

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi renin e ditës pa pikën 4.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-së me 24.11.2022

zv.Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Përhëndetje, unë nuk kam vërejtje. Ndoshta është e mira që në Komitete ka filluar me u bë një praktikë e shkrimit më të shkurtë po pak më domethënës, për shkak se ne dimë shumë herë ti stërzgjatim diskutimet, po e rëndësishme është që thelbi i diskutimeve tona të paraqitet në Proces-Verbal. Prandaj kam një përgëzim për sekretariatit në përgjithësi për procesmbajtësit që po e vazhdojnë një punë të mirë në lidhje me Komitet, ndërsa me Kuvend është çështje tjetër që duhet me diskutuar në seancat e ardhshme.

z.Ibrahim Demiri ZKKK; A publikohen Proces -Verbalet në Web-faqën e Komunes?

z.Idajet Rexhepi, zyrtar i Kuvendit; Po

zv.Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KPK-së e mbajtur më 24.11.2022**

Pika 2

Draft – plani i punës, të Komitetit për Komunitete për vitin 2023

zv.Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Ka qenë mirë që mos të lëmë zbrastësira, ta bëjmë një plan të mirë të punës të këtij Komiteti. ZKKK-ja e ka një propozim të mirë, por ne duhet ta kemi një plan gjithëpërfshirës sikurse Komitetet tjera, të ndarë me muaj. Jam që ta bëjmë një diskutim të mirë sepse jemi Komitet që duhet me shkua me rekomandime të qarta për të gjithë edhe për Kuvendin. Në muajin Janar ta aprovojmë një plan të mirë të punës për vitin 2023.

zv.Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti; Plani na jepe rrugën se si me punuar. Atëherë po e lëmë që plani i punës të aprovohet në Janar, bashkë me vendimin për orarin e mbledhjeve.

***Komiteti për Komunitete, vendosi që plani i punës për vitin 2023, si dhe orari i mbledhjeve të përshtatet dhe të aprovohet në Janar 2023.**

Pika 3

Diskutim për Draft – Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023

zv.Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Kjo ka me shkuar në diskutim publik, do të presim çka po flasin qytetarët, pastaj ne do të japim mendimin tonë.

z.Besnik Seferi; Kjo ka shkuar në diskutim publik, edhe ne si Komitet jemi pro për diskutim publik. Sa i përket kërkesës për ngritjen e çmimeve të shërbimeve nga “Pastërtia”, kjo është njësi nga ajo në Ferizaj, dhe kanë problem, sepse mjete financiare i grumbullon Ferizaj. Kjo rritje ka me i prekur klientët. Mendoj se një ngritje e tillë nuk është e madhe nga 4.94 në 5.99€, është një rritje për një euro. Kjo ngritje ka me u bë edhe nëse nuk e bëjmë ne, do ta bënë Ferizaj, sa kamë informata unë. Ta nxjerrim një rekomandim për ngritjen e çmimit për 1 euro.

z.Arton Demiri; Unë punojë qatë në KRM “Pastërtia”, vërtet mendoj se për një euro ngritje nuk është ngarkesë e madhe për klientët, sepse në kontejner klientët po qesin çmos. 80 raste janë që veç i qesin kantatë e nuk paguajnë fare, fjalën e kamë edhe për ata që i kanë blerë vet kontejnerët.

znj.Rrezartë Ramadani; Ne veç e shtymë pikën e 4 të rendit të ditës e tani më nuk mund të nxjerrim ndonjë rekomandim.

z.Besnik Seferi; Duke parë diskutimet unë po them që vetëm ta përkrahim që rregullorja me shkua në diskutim publik, kështu që po tërhiqem nga propozimi për ta nxjerr një rekomandim.

zv.Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti; Kuvendi e ka qitë në diskutim publik Rregulloren për taksa për 2023, ne mund ta japim kontributin tonë gjatë diskutimit publik.

Pika 4

Të ndryshme

zv.Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti; Hapi diskutimin për këtë pikë.


z.Besnik Seferi; Ne si Komitet ja kemi filluar pak vonë deri sa u themelua Komiteti, kështu që edhe kemi pasur shumë sfida, po shpresoj që në vitin 2023 do të fillojmë mbarë me një punë të suksesshme. E falënderojmë z.Ibrahim Demirin për punën e bërë, i urojmë shëndet të mirë dhe vit të mbar në 2023. Meqenëse sa e di unë në fillim të vitit shkon në pension.

znj.Rrezartë Ramadani; Edhe unë të gjithëve ju uroj festat e fund vitit, urojë të keni suksese dhe mbarësi.

zv.Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti; Urime edhe nga unë vitin e ri 2023. Suksese dhe të gjitha të mirat për te gjithë anëtarët e Komitetit.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte zv.Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15.05h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



zv.Kryesuesi i Komitetit
Muhamet Mehmeti

